

Data 27/05/2025

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Krijimi i një modeli të integruar të zhvillimit në formën e një parku multifunksional me temën e 100 fshatrave: “Ferma Didaktike Valias.” Kontratë me çelësa në dorë.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.

Fondi limit: 499,725,589.62 Leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe pika 2/b e nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndermjet kufirit të lartë monetar dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006,

"Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, 2024** të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja b" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore e situacionit perfunditar të deklaruar në organet tatimore
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufiri të ulët dhe të lartë monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve. Licenca duhet të përmbajë kategoritë e punimeve të kontratës si më poshtë:

PER PUNIMET E PERGJITHSHME TE NDERTIMIT

- NP 1 A Punime gjurmimi në tokë.
- NP 2 E Ndërtime civile dhe industriale.
- NP 4 B Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- NP 5 A Punime nëntoksore, ura e vepra arti.
- NP 11 A Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

PER PUNIMET SPECIALE TE NDERTIMIT

- NS 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.
- NS 2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
- NS 6 A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
- NS 8 C Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.

- NS 9 A Punime strukturorë speciale.
- NS 10 A Shtresa dhe mbistruktura speciale
- NS 12 B Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
- NS 18 A Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

ARGUMENTIMI LICENCAT

Kategoria e kërkuar		Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP 1	A	Punime gjurmimi në tokë.	Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, kategoria III Gjurmim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me zinxhir 1.0m3, shkarkimi ne toke Transport dheu me auto deri 5.0 km Mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke te zakonshme Gjurmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet Gjurmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne mjet Gjurmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi	0-20 milion lekë	4,971,091

			deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne toke		
NP 2	E	Ndërtime civile dhe industriale.	Shtrese me pllaka grez porcelanato Shtrese betoni C 12/15 Shtrese betoni C 16/20 F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm Struktura monolite betoni C 12/15 Dyer d/alumini dopio xham Dritare d/alumini dyfi xh. F V dyer te brendeshme druri cilesi e I-re. Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 30/37 Kollona b/a monolite C 30/37 h ~ 4m Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 30/37 Trare e arkitrare b/a C30/37 h ~ 4m Soleta b/a me polisterol dhe rrjete teli C 30/37 t=30cm, h~4m Soleta te plota b/a C30/37 (perfshire shkallet) Ndertim skeleti per serat (Perfshin te gjitha punimet dhe pajisjet e nevojshme per montimin e skeletit) Furnizim dhe vendosja e Panele Sandwich per mbulesen e ambientit (Perfshin te gjitha punimet dhe pajisjet e nevojshme per montimin e strukture me panale sandwich) Furnizim vendosje Veshje fasade me Panele Sandwich (Perfshin te gjitha punimet dhe pajisjet e nevojshme per montimin e strukture me panale sandwich per veshjen e fasadave) Lesh guri (perfshire gjithe aksesoret e nevojshem per instalimin) Tavane gipsi (perfshire gjithe aksesoret e nevojshem per instalimin) Dyer te jashtme te pershtatshme per ambiente stallash (Perfshin te gjitha punimet dhe pajisjet e nevojshme per montimin e dyerve) Rrethim i stalles blegorale se lopeve me material te kombinuar dru dhe rrejte, lartesia e rrethimit min H=1.5m Shtirim I dyshemese se rrejtezuar PVC (perfshin te gjithe zerat e nevojshem per shtirimin me shtrese PVC te rrejtezuar te siperfaqeve te brendshme te objektit) Rrethim i stalles blegorale se Dhive me material te kombinuar dru dhe rrejte, lartesia e rrethimit min H=1.5m Rrethim I fermes Porte metalike ne hyrje te rrethimit Cezme e jashtme F V Pllake b/a C 25/30, per Mbeshtetjen e hidrantit, Sipas vizatimit perkates. Xham struktural I pathyeshem Shtirim I dyshemese me beton te varfer (perfshin te gjitha shtresat e nevojshme per shtirimin e siperfaqeve te brendshme te objektit) Panele HPL per tualete dhe dyer Suvatim dhe lysterje e siperfaqeve te brendshme perfshire	201-400 milion lekë	255,416,434

			muret dhe tavanet.		
NP 4	B	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	Shtrese çakell me makineri t=20cm, me cilindrim Shtrese zhavori Nenshtrese rere F V bordura betoni 12x25cm Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka Shtrese stabilizant t=10cm Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur me makineri Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri Shtrese binderi me granil gur kave,6cm, me makineri Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	21-50 milion lekë	35,730,199
NP 5	A	Punime nëntoksore, ura e vepra arti.	Ndertim drenazhi, mbushje me rere natyrale Ndertim puseta betoni H=2.5-3m, D=1m + kapak gize F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm Mbrotjtje kanali me palankola per thellesi >1.7m Pusete betoni tip, lidhje vetjake: Dia.800mm, sic tregohet ne vizatim, thellesi deri ne 1.5m F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=200 mm	0-20 milion lekë	5,132,591
NP 11	A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorë ve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.	F.V. Instalime elektrike njesi sherbimesh, Perfshin punimet dhe pajisjet. (Instalime elektrike priza, kablllo, kuti shperndarjese, tuba plastik), sensor, fibra optike, CCTV, NVR, sistem alarmi etj. F.V. Rrjeti linja T.U ('Perfshin te gjitha punimet dhe pajisjet e nevojshme per funksionimin e nje rrjeti transmisioni energjie ne tension te ulet. Si kablllo bakri, tuba PVC, punime germimi dhe puseta betoni per matje) F.V. Rrjeti i furnizimit te ndricimit ('Perfshin te gjitha punimet dhe pajisjet e nevojshme per funksionimin e nje rrjeti ndricimi publik. Si kablllo bakri, tuba PVC, punime germimi, shtylla metalike, ndricues, puseta plastike matjeje dhe per shtyllat) Ndricues te jashtem te montuar ne fasade	0-20 milion lekë	18,241,043
NS 1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve	Çmontim I seres ekzistuese dhe prishje e nenstruktures (Perfshihen punimet e cmontimit te seres ekzistuese konstruksioni metalik dhe mbulimi I seres, prishja e themeleve prej beton arme, Shtrese zhavorri, dhe soleten e bazamantit te objektit dhe heqja e tavolinave te rrenjezimit) Prishje e shtreave ekzistuese te betonit rreth godines	0-20 milion lekë	1,001,040
NS 2	A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, Pn 16 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=63mm, Pn 16 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=110mm, Pn 16 Instalim I sistemeve hidrosaniare (perfshin punimet e nevojshme per instalimin e sistemeve te ujit te frohte dhe te ngrohte sanitar si dhe instalimin e kanalizimeve dhe drenazheve te objektit) Impjanti I pastrimit te ujerave (perfshire zinxhirin e pastrimit te mbetjeve, vaska e tharjes se llumit, grope sedimentesh,	0-20 milion lekë	12,565,427

			rakorderite makinerite e perpunimit dhe pompat) Furnizimi Vendosja e lidhjes së ujit Lloji 1 duke përfshirë ujëmatësin (Diametri 1 1/4") Pusete hidranti bashke me te gjitha rakorderite Furnizimi dhe vendosja e Dhomës së Valvulave Ajrore duke përfshirë punimet civile, strukturore dhe pajisje Furnizimi dhe vendosja e dhomës së larjes duke përfshirë punë civile, strukturore dhe pajisje Furnizim vendosje shirit sinjalizimi per tuba HDPE me fije alumini I dallueshem nga dedektore metalik Kanal kullimi me zgare metalike, per largimin e ujrave, sipas vizatimit F.V Dalje Dripi me Tuba HDPE PN10 d=90mm, cilesi mesatare me jetegjatesi 5 vite UjeMates DN 100 Pusete komandimi drejtkëndëshe 2.5x2.5m siç tregohet në vizatim Hidrante (Perfshihen germim, mbushja me rërë, transport, mbushje me material, F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=110mm, PN 10, F.V Saraçineske DN100, Pjese Cmontuese DN 100, F.V hidrante Ø 100 mm, Pjes tubi me fillanxha DN100 L=1100mm çelik, Brryl Tip DuckFoot DN100) F.V Dalje Dripi me Tuba HDPE PN10 d=25mm, cilesi mesatare me jetegjatesi 5 vite F.V Dalje Dripi me Tuba HDPE PN10 d=63mm, cilesi mesatare me jetegjatesi 5 vite Saracineska te thjeshta per hapje dhe mbyllje dripi Montim Pompe Depozite uji Qafa llamarine Ø 150mm Tub Fleksibel I termoizoluar Ø 150mm Furnizimi i pajisjve dhe pompave në konfigurimin 1+1 (q=8 l/s, H=32m) me shtytës prerës.		
NS 6	A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.	F.v. Tabele rrethi "detyrim" e vogel me D = 40 Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikopponente (paste) Vijezimet e kalimit te kembesoreve. Bikomponente (paste) F.v. kurrize artificiale h =3cm	0-20 milion lekë	601,691
NS 8	C	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.	F V konstruksione metalike te thjeshta Furnizim vendosje flete polikarbonate Clear UV rezistente per fasada (Perfshin te gjitha punimet dhe pajisjet e nevojshme per montimin e elementeve plastike per mbulimin e seres) Furnizim vendosje fasade xhami (Perfshin te gjitha punimet dhe pajisjet e nevojshme per montimin e elementeve prej xhami, dyer. Skelete etj) Fasade me pllaka çimentoje me mbulese tekstili 20mm (perfshire stuko per patinim, boje dhe rezine transparente)	51-100 milion lekë	87,637,806
NS 9	A	Punime strukturorë speciale.	Shpim me sonde Ø 0.8 m, ~ 15 m, (perde mbajttese).	0-20 milion lekë	3,817,956

NS 10	A	Shtresa dhe mbistruktura speciale	Shtirim I dyshemese me rezine (perfshin te gjithe shtresat e nevojshme per shtrimin e siperfaqeve te brendshme te objektit) Shtirim I dyshemese me beton dhe kuarç, trajtuar me helikopter (perfshin te gjithe shtresat e nevojshme per shtrimin me beton trajtuar me helikopter te siperfaqeve te brendshme te objektit)	0-20 milion lekë	5,005,199
NS 12	B	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.	"Aspirator inline Prurja 415m³/h diam: 150 mm Fuqia: 42w" "Tubacione dhenje dhe thithje ajri, panel sandwich, prej shkume poliuretani te zgjeruar, te veshur me flete alumini nga te dyja anet brenda/jashte me spesor 80/120 mikron, bashke me aksesoret e prodhimit, perforcuese, izolim me silikon, bashkim me bajoneta, flanaxha prej alumini te anodizuar. Tub Fleksibel I termoizoluar Ø 125mm Tub Fleksibel I termoizoluar Ø 200mm Qafa llamarine Ø 125mm Qafa llamarine Ø 200mm Grile 45° 30x15cm Grile Lineare 60x15 cm Grile shiu 40x20cm Grile shiu 70x40cm Atrecature ndihmese per realizimin e Impiantit Tub Cu i paratermoizoluar Ø 6.3 mm, i pershtashem per presion pune deri 40 bar. Tub Cu i paratermoizoluar Ø 9.52 mm, i pershtashem per presion pune deri 40 bar. Tub Cu i paratermoizoluar Ø 12.7 mm, i pershtashem per presion pune deri 40 bar. Tub Cu i paratermoizoluar Ø 15.88 mm, i pershtashem per presion pune deri 40 bar. Tub Cu i paratermoizoluar Ø 19.1 mm, i pershtashem per presion pune deri 40 bar. Tub Cu i paratermoizoluar Ø 22.2 mm, i pershtashem per presion pune deri 40 bar. Termoizolim Ø 28 mm. Rakorderi PP Degezues Y 18-28 Kw Degezues Y max 28-56 Kw Kabell komunikimi I skremuar per komunikimin ndermjet paisjeve te brendshme dhe te jashme. Gaz R410 Tub PP Ø 32 mm per linjen e shkarkimit te kondensatit bashke me elementet e nevojshem per montim. Termoizolim Ø 35 mm. Tub Cu i paratermoizoluar Ø 12.1 mm, i pershtashem per presion pune deri 40 bar. Tub Cu i patermoizoluar Ø 28 mm, i pershtashem per presion pune deri 40 bar. Tub Cu i patermoizoluar Ø 35 mm, i pershtashem per presion pune deri 40 bar. Termoizolim Ø 42 mm. Grile shiu 80x60cm Tub Cu i patermoizoluar Ø 42 mm, i pershtashem per	21-50 milion lekë	35,446,197

		presion pune deri 40 bar. "Aspirator inline. Prurja 220 m3/h. diam: 125 mm .Fuqia: 23w" Grile Tranzit 50x15 cm Grile Riqarkullimi f+m 40x100 cm Grile shiu 120x70cm Termoizolim Ø 41 mm. Grile Lineare 60x20 cm Grile Lineare 100x20 cm Grile 45° +F+M 25x80cm Grile 45° +F+M 40x140cm Grile 45° +F+M 60x140cm Montim njesi kondicionimi Ventilatorë për nxjerrjen e ajrit (Ventilatore AC) për sera "Njesi e brendshme kondicioner kasete Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 28.0/31.5 kW Fuqia e instaluar 0.65Kw Prurja e ajrit Q=4320 m3/h Dim= 470x1380x1100 mm" "Njesi e brendshme kondicioner kasete Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 16.0/18.0 kW Fuqia e instaluar 0.247Kw Prurja e ajrit Q=2340 m3/h Dim= 245x1550x800" "Njesi e jashtme Modulare Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 67.4 / 75 Kw Fuqia e instaluar 18.3 kW Temperatura e punes -20/+43°C EER=3.7 ne ftohje , COP= 4.1 ne ngrohje . Dimensionet =(1685x1240x765 mm)x3 Pesha = 396 kg" " Rekuperator ajri (Q=7000 m3/h) . Presioni P= 80 Pa. Rendimenti rekuperatorit η=55%. Karakteristikat teknike sipas projektit dhe specifikimeve teknike . " " Rekuperator ajri (Q=2500 m3/h) . Presioni P= 80 Pa. Rendimenti rekuperatorit η=55%. Karakteristikat teknike sipas projektit dhe specifikimeve teknike . " "Njesi Kondicionimi -MonoSplit mural 7.1 kw ftohje 8.2 kw ngrohje, Ajer: 1074 (m3/h) Klasi energjik A+ / A+ Temperaturat e punes -15 / +46 °C " " Njesi e brendshme kondicioner kanalor Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 12/14 kW Fuqia e instaluar 0.177 Kw Prurja e ajrit Q=2160 m3/h Dim=1400*800*245 mm " "Njesi e jashtme Modulare Kondicionimi Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 33.5-33.5 kW Fuqia e instaluar 8kW Temperatura e punes -20/+46°C EER=4.11 ne ftohje, COP= 4.39 ne ngrohje. Dimensionet =1615/940/460 mm Pesha=180 kg " " Rekuperator ajri (Q=2750 m3/h). PresioniP= 100 Pa. Rendimenti rekuperatorit η=55%. Karakteristikat teknike sipas projektit dhe specifikimeve teknike. " "Rekuperator ajri (Q=3000 m3/h). Presioni P= 120 Pa. Rendimenti rekuperatorit η=55%. Karakteristikat teknike sipas projektit dhe specifikimeve teknike. " "Njesi Kondicionimi -MonoSplit mural 2.5 kw ftohje 2.8 kw ngrohje, Ajer: 624 (m3/h) Klasi energjik A++ / A+ Temperaturat e punes -15 / +48 °C " "Njesi e brendshme Kondicionimi kondicioner kasete Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 14.02/16.0 kW Fuqia e instaluar 0.018 Kw Prurja e ajrit Q=1980 m3/h Dim=204x840x840 mm, Dim paneli:50x950x950"	
--	--	--	--

		"Njesi e brendshme Kondicionimi kondicioner kasete Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 2.8/3.2 kW Fuqia e instaluar 0.017 Kw Prurja e ajrit Q=750 m3/h Dim=204x840x840 mm, Dim paneli:50x950x950" "Njesi e brendshme Kondicionimi, kondicioner murale Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 2.2/2.5 kW Fuqia e instaluar 0.02 Kw Prurja e ajrit Q=450m3/h Dim=290x795x264 mm" "Njesi e brendshme Kondicionimi, kondicioner murale Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 1.7/1.9 kW Fuqia e instaluar 0.02 Kw Prurja e ajrit Q=420m3/h Dim=290x795x264 mm" "Njesi e jashtme Modulare Kondicionimi Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 90 / 100 Kw Fuqia e instaluar 26 kW Temperatura e punes -20/+43°C EER=3.77 ne ftohje, COP= 4.19 ne ngrohje Dimensionet =(1685x1240x765 mm)x2 Pesha = 396 kg" " Rekuperator ajri (Q=2200 m3/h). Presioni P= 120 Pa. Rendimenti rekuperatorit η=55%. Karakteristikat teknike sipas projektit dhe specifikimeve teknike. " "Njesi e jashtme Modulare Kondicionimi Kapaciteti ne ftohje ngrohje 61.5 / 69 Kw Fuqia e instaluar 16.48 kW Temperatura e punes -20/+43°C EER=3.77 ne ftohje, COP= 4.19 ne ngrohje . Dimensionet (1685x1240x765mm) x2 Pesha = 396 kg" "Rekuperator ajri (Q=5000 m3/h). Presioni P= 110 Pa. Rendimenti rekuperatorit η=55%. Karakteristikat teknike sipas projektit dhe specifikimeve teknike. " "Njesi Kondicionimi -MonoSplit mural 5.0 kw ftohje 6.0 kw ngrohje, Ajer: 1038(m3/h) Klasi energjik A+ / A+ Temperaturat e punes -15 / +46 °C " "Njesi e brendshme Kondicionimi kondicioner kasete Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 9.0/10.0kW Fuqia e instaluar 0.045 Kw Prurja e ajrit Q=1368 m3/h Dim=204x840x840 mm, Dim paneli:50x950x950" "Njesi e brendshme Kondicionimi kondicioner kasete Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 7.1/ 8.0 kW Fuqia e instaluar 0.028 Kw Prurja e ajrit Q=990 m3/h Dim=204x840x840 mm, Dim paneli:50x950x950" "Njesi e brendshme Kondicionimi kondicioner kasete Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 5.6/5.0 kW Fuqia e instaluar 0.023Kw Prurja e ajrit Q=900 m3/h Di Dim=204x840x840 mm, Dim paneli:50x950x950" "Njesi e brendshme Kondicionimi kondicioner kasete Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 4.5/6.3 kW Fuqia e instaluar 0.018 Kw Prurja e ajrit Q=816 m3/h Dim=204x840x840 mm, Dim paneli:50x950x950" "Njesi e jashtme Modulare Kondicionimi Kapaciteti ne ftohje /ngrohje 151.2 / 169.5 kw Fuqia e instaluar 43.8 kW Temperatura e punes -20/+43°C EER=3.4 ne ftohje , COP= 3.9 ne ngrohje . Dimensionet (1685x1240x765 mm) x3" "Njesi e jashtme Modulare. Kondicionimi Kapaciteti ne ftohje/ngrohje 95.4 / 106.05 Kw Fuqia e instaluar 27.4 kW Temperatura e punes -20/+43°C EER=3.4 ne ftohje , COP= 3.9 ne ngrohje . Dimensionet (1685x1240x765 mm) x2 Pesha = 396 kg"	
--	--	--	--

		"Njesi e brendshme Kondicionimi kondicioner kasete Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 14/16.0 kW Fuqia e instaluar 0.071 Kw Prurja e ajrit Q=1980 m3/h Dim=204x840x840 mm, Dim paneli:50x950x950" "Njesi e brendshme Kondicionimi kondicioner kasete Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 11.2/12.5 kW Fuqia e instaluar 0.071 Kw Prurja e ajrit Q=1590 m3/hDim=204x840x840 mm, Dim paneli:50x950x950" "Njesi e brendshme Kondicionimi, kondicioner kasete Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 3.6/4.0 kW Fuqia e instaluar 0.017 Kw Prurja e ajrit Q=750 m3/h Dim=204x840x840 mm, Dim paneli:50x950x950" "Njesi e jashtme Modulare Kondicionimi Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 90 / 100 Kw Kw Fuqia e instaluar 26 kW Temperatura e punes -20/+43°C EER=3.46 ne ftohje , COP= 3.91 ne ngrohje . Dimensionet (1685x1240x765 mm)x2 Pesha = 396 kg" "Njesi e jashtme Modulare Kondicionimi Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 50.4 / 56.5 Kw Fuqia e instaluar 14.6 kW Temperatura e punes -20/+43°C EER=3.36 ne ftohje , COP= 3.87 ne ngrohje . Dimensionet =1685x1240x765 mm Pesha = 396 kg" Rekuperator ajri (Q=1500 m3/h). Presioni P= 80 Pa. Rendimenti rekuperatorit η=55%. Karakteristikat teknike sipas projektit dhe specifikimeve teknike. Rekuperator ajri (Q=1000 m3/h). Presioni P= 80 Pa. Rendimenti rekuperatorit η=55%. Karakteristikat teknike sipas projektit dhe specifikimeve teknike. Njesi e brendshme Kondicionimi kondicioner kasete Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 5.6/6.3 kW Fuqia e instaluar 0.089 Kw Prurja e ajrit Q=912 m3/h Dim=204x840x840 mm, Dim paneli:50x950x950 Njesi e brendshme Kondicionimi, kondicioner kanalor Kapaciteti ne ftohje / ngrohje 3.6/4 kW Fuqia e instaluar 0.071 Kw Prurja e ajrit Q=480m3/h Dim=750*620*200 mm			
NS 18	A	Punime topogjeodezike	Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik	0-20 milion lekë	-

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të ketë stafin drejtues teknik të punësuar dhe regjistruar si më poshtë:

- 2 (dy) Inxhinierë Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës e vlefshme

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

2.3.3.1 Staf Mbështetës

1(Nje) Projektues Arkitekt (Licensa 2 a, d: Projektim arkitekturor për - objekte industriale - objekte turistike, Projektim peizazh, sistemime sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.)

1(Nje) Projektues Konstruktor (Licensa 3 a, b-2: Projektim objekte civile – industrial – turistike, prej murature dhe skelet beton arme deri në 5 kate, objekte me skelet metalik.)

1(Nje) Projektues Instalator (Licensa 4 a,b,c,j:Projektim të instalimeve hidro-termosanitare, Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme-Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale-Projektim të sistemeve kundër zjarrit- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale).

Stafi i sipërcituar është staf mbështetës për përgatitjen e projektit të zbatimit (Faza V-VI).

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për projekte të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

Për secilin punonjës të paraqitet:

- Diploma,
- Kontrata e punës së vlefshme
- CV

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 39 pika 6/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin e zbatimit, specifikimet teknike, raportet teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin e objektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

ARGUMENTIMI STAFI DREJTUES

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

Inxhinier Ndërtimi	Punime gjurmimi në tokë. Ndërtime civile dhe industriale. Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri. Punime nëntokësore, ura e vepra arti. Punime për prishjen e ndërtimeve. Punime strukturorë speciale. Shtresa dhe mbistruktura speciale.
Inxhinier Elektrik	Ndërtime për nënstacione, gabinetat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike
Inxhinier Mekanik	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
Inxhinier Hidroteknik	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
Inxhinier Gjeodet	Referuar projektit të zbatimit dhe relacionit teknik.
Inxhinier Mjedisit	Punime të inxhinierisë së mjedisit.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi 2.3.4: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesat e mësipërme mbështen në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të

ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" rekomandohet të jete ne kantier per minizimin e aksidenteve ne pune

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **56** persona për periudhën, tremujore nga data e zhvillimit të procedurës e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit,

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar në të cilin thuhet: "Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës" dhe nenin 39 pika 6/ç të VKM nr.285/2021 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar. Numri i punonjësve është percaktuar bazuar tek faktorët si, volumet dhe kategoritë e punimeve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendosija e këtij kriteri, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacioneve dhe raporteve teknike të projektuesit, numri i punonjësve është plotësisht i justifikuar. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar perinformatizimin e manualit të cmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" Bazuar në kriter elementet e strukture së kostos (material, punetori, makineri, transport) zeri fuqi punëtore ze rreth 15% të kostos.

Total ore pune = 236,076 ore (referuar oreve të punës për çdo ze pune të preventivit)

Ore/1 ditë pune = 8 ore

Total Ditë pune punetori = 236,076 ore/8 ore= 29,510 ditë pune

Dite pune gjithesej= 24 muaj (sipas grafikut te punimeve) * 22 dite/muaj= 528 dite pune
 Numri i fuqise puntore = 29,510 dite / 528 dite = 56 punetore afersisht..

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ne pronesi, ose qira, ose kontrate furnizimi.

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasia	Statusi
1	Ekskavator me Goma	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës deri 20 Ton	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
3	Kamion me kapacitet mbajtës nga 10 deri 25 Ton	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
4	Kamioncine	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
5	Kamion i pajisur me Vinc min 15 Ton	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
6	Fadroma	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
7	Autobot Uji	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
8	Autobetoniere	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
9	Autopompe	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
10	Gjenerator	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
11	Vibrator	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
12	Betoniere min 350 Lt	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
13	Miniekskavator	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
14	Greider	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
15	Asfaltoshtuese	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
16	Autobitumatrice	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
17	Rul Gome-Hekur	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
18	Rul Hekur-Hekur	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
19	Sonde per pilota thellësi minimumi 10 m dhe diametër minimumi 0.8 m.	Copë	1	Ne pronesi ose me qera

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet te jene te angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira, do të paraqiten keto dokumenta:

- Për mjetet ne pronesi (që shënohen në regjistra publikë), duhet të paraqiten;- dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), -plus certifikaten e kontrollit teknik, -siguracionin e mjetit (te vlefshme), vertetimin e pageses per taksat vjetore.
- Për mjetet e siguruar me qira, duhet të paraqiten; -dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme), vertetimin e pageses per taksat vjetore, kontrata e qirase e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.

- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afatit të zbatimit të cilave shtrihet për gjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Numri i makinerive është përcaktuar në bazë të grafikut të detajuar për zbatimin e punimeve sipas proceseve të punës, i përgatitur nga ana e projektuesit, ku për secilën proces pune është përcaktuar lloji i makinerive dhe ditët e punës përkatëse. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira / kontrate furnizimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

ARGUMENTIMI I MJETEVE

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasia	Emertimi i punimeve
1	Ekskavator me Goma	Copë	1	Punime gërmimi në tokë. Ndërtime civile dhe industriale. Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri 20 Ton	Copë	2	
3	Kamion me kapacitet mbajtës nga 10 deri 25 Ton	Copë	1	
4	Kamioncine	Copë	2	

5	Kamion me Vinc min 15 Ton	Copë	1	druri.
6	Fadroma	Copë	1	Punime nëntokësore, ura e vepra arti.
7	Autobot Uji	Copë	1	Punime për prishjen e ndërtimeve.
8	Autobetoniere	Copë	2	
9	Autopompe	Copë	1	Punime strukturorë speciale. Shtresa dhe mbistruktura speciale.
10	Gjenerator	Copë	1	
11	Vibrator	Copë	2	Ndërtime për nënstacione, gabinet e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.
12	Betoniere min 350 Lt	Copë	2	
13	Miniekskavator	Copë	1	
14	Greider	Copë	1	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
15	Asfaltoshtruese	Copë	1	
16	Autobitumatrice	Copë	1	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
17	Rul Gome-Hekur	Copë	1	
18	Rul Hekur-Hekur	Copë	1	Punime të inxhinierisë së mjedisit.
19	Sonde për pilota thellësi minimumi 10 m dhe diametër minimumi 0.8 m.	Copë	1	

2.3.7 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë ose (ekuivalent)
- ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë ose (ekuivalent)
- ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë ose (ekuivalent)

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurrohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti

kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

-Projekti i zbatimit, Specifikimet teknike, raportet teknik, preventivi me zerrat e punimeve, grafiku i punimeve janë hartuar nga projektues i licencuar dhe janë pjesë e pandare e DST.

Ne cdo rast nese janë përmendur marke prodhimi ose proces i vecante pranohen edhe ekuivalent.

ARGUMENTIMI I KRITEREVE PËRZGJEDHËS PËR KUALIFIKIM

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

1. Çmimi	pikët	70
2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë	pikët	5
3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet)	pikët	10
4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)	pikët	10
5. Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)	pikët	5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi

[0 - 70] pikë

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime

2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë

[0 –5 pikë]

Argumentimi: Operatori Ekonomik për të vlerësuar për këtë kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën të stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si më poshtë:

- *Punime për ndërtimin e objekteve të reja administrative, bujqësore, industriale dhe teknologjike me sipërfaqe ndërtimi jo më pak se 13,386 m² për kontrata të kryera gjatë tre viteve të fundit*

*Përlllogaritja e volumit specifik do të kryhet në varesi në kohezgjatjes së kontratës (data e fillimit të punimeve-data e përfundimit të punimeve) pavarësisht periudhës brenda së cilës janë realizuar këto volume specifike.

* Ky është kriter vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 3 vjeçar. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës. Vlera e kontratave të mëparshme dhe specifikisht vlera e punime dhe volume të kryera të realizuara, ndikon në disa aspekte të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, sikurse janë: i. stabiliteti financiar dhe kapaciteti; -cilësia dhe standardet; -historia e suksesit; -trajtimi i kompleksitetit Për të vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë “0” pikë.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} \times P_{\max k2} / V_{\max k2}$$

P_{k2} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k2}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike të kryera)

$P_{\max k2}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Përmbushja e këtij kriteri do të provohet nëpërmjet situacioneve përfundimtare, aktit të kolaudimit sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit Teknik, dorëzimit të te detyrueshem të informacionit të përmbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1) dhe çdo dokumentacion provues (sipas rastit) për volumet e kërkuara (leje ndërtimi, projekti etj).

Volumet specifike për kontrata të cilat nuk janë kolauduar nuk do të përfshihen në përlllogartje.

3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–10 pikë]

Argumentimi: Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qënë i detyruar të zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryejë. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe paisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:

$$P_{k3} = O_{k3} \times P_{\max k3} / V_{\max k3}$$

P_{k3}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\max k3}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k3}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k3}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)

[0 - 10 pikë]

Argumentimi: Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- **Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k4} = O_{k4} \times P_{\max k4} / V_{\max k4}$$

P_{k4}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\max k4}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k4}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k4}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

Shënim: Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohe nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4.

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë garancine sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %) [0 - 5 pikë]

Argumentimi: Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë ofertën për vlerën PSK në rubriken specifike/zerin “Siguria në kantier (Plani I Sigurisë e Kordinimit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, datë 13.04.2023)”, në preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur në mënyrë të posacme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë në kantier, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti

në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Siguria në kantier, përfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatëse të referuara). Ky parashikim shërben në mënyrë të vecantë për përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrësve, në mënyrë që të shmangen/zvogëlohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe të përmbushen të drejtat e punëmarrësve për punë të denjë të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së.

Për shkak të rëndësisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e vecantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet në Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”* (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrikë në masën jo më pak se 3%, përlogaritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas percaktimeve të VKM nr. 216 datë 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur në vlerë, në këtë rast jo më pak se **8,391,538.54** leke pa tvsh. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”*, Aneksi VI *“Përmbajtja minimale e planit të sigurisë në kantieret e perkoheshme e të levizeshme”*.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social, propozim i ofertuesit do të konsiderohet vlera e ofertuar nga operatori ekonomik për zërin Siguria në kantier (Planin e Sigurisë e Kontraktorit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit të shtuar), e përfshirë në ofertën ekonomike të detajuar, konkretisht sipas Shtojcës 2 të DT. **“LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”**

- **Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlera 8,391,538.54 leke pa tvsh.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlera 8,391,538.54 leke pa tvsh, do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë PSK – Sigurie në kantier më të lartë se vlera 8,391,538.54 leke pa tvsh do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = O_{k5} / V_{\max k5} \times P_{\max k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k5}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar në kantier/shendeti, impakti në mjedis dhe social (PSK)”, **kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlerës së kërkuar.**

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilesia në punime: siguria në kantier/shendeti, impakti në mjedis dhe social” **nëse vlera e saj do të jetë më shumë se dyfishi i mesatares së ofertave të vlefshme.**

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia në punimet e kryera: siguria në kantier/shendeti impakti në mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O – (pikët e Ofertës)

Mo – Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme

N – Numri i ofertave të vlefshme

PR (Rrm) – Rritje e mundshme

Mo = $O_1 + O_2 + O_3 + \dots + O_n / N$

PR = 200 % Mo

Vlera e ofertave të ofruara > PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia në punimet e kryera: siguria në kantier/shendeti impakti në mjedis”.

Kujdes!!!

Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.

Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përlogaritët në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.

Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.

Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK ($200\% MO = 51,500,000 \text{ leke} < 55,000,000 \text{ leke}$) dhe vlerësohet me 0 pike.

Ne rastin kur Ofertuesi D merr pikët maksimale për kriteret e tjera vlerësuese, pra në rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlera për PSK do të jetë 55,000,000 leke.

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vlerës së sipercituar për sigurinë në kantier në çdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese të realizimit të punimeve, kjo e shoqëruar me (i) raportin PSK (referuar përmbajtjes minimale të PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresit të punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistët e HSE (Health, Safety and Environment) të autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nëse nga monitorimi i specialistëve të HSE dhe Mbikqyresit të punimeve rezulton se nuk janë zbatuar masat e sigurisë në kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) përveç masave penalizuese referuar KPK dhe KVK të kontratës, vlera korresponduese për këtë rubrikë nuk do të paguhet për situacionin mujor referues.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Projekti teknik, Specifikimet teknike, raportet teknike, preventivi me zerrat e punimeve, grafiku janë hartuar nga subjekt projektues të licencuar dhe janë pjesë e DST.

Ne cdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante ne kete procedure prokurimi do te pranohen edhe ekuivalent